

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2025

Në mbështetje të nenit 158, pika 3, gërma “a”, dhe “ë” të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Politikën e Burimeve Njerëzore në KESH sh.a, Shoqëria KESH sh.a shpall konkursin për 12 vende të lira të punës "Remontier" në Repartin Mekanik, Sektori i Mirëmbajtjes, në Njësitë Prodhuese sipas nevojave të tyre si më poshtë vijon:

Në Njësinë Prodhuese HEC - Fierzë – 4 Remontier

Në Njësinë Prodhuese HEC - Koman – 6 Remontier

Në Njësinë Prodhuese HEC - Vau i Dejës – 2 Remontier

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme të pranimit në punë

Kualifikimi Minimal / Kompetencat

- Arsim i Mesëm Profesional (Mekanik);
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese;
- Kualifikime të tjera (kanë përparësi).

Përshkrimi i shkurtër i punës

- Realizojnë kryerjen me cilësi të shërbimeve në përputhje me rregulloren teknike, manualët dhe instruksionet përkatëse të makinerive dhe të paisjeve për mirëmbajtjen e anës mekanike të tyre si: Turbinat ; Gjeneratorët; Sistemet e rregullimit automatik të Turbinave; Sistemet e qarkullimit dhe injektimit(HEC-et Fierze,Koman); Sistemin e ujit ftohës; Impjantin hidraulik në Veprën e Marrjes; Sistemin e frenimit dhe të ngritjes së rotorit; Kompresoret dhe sistemin e ajrit të komprimuar; Pompat e drenazheve, thellësisë dhe galerisë së digës; Vinçat në Sallën e Makinave, në Bjefin e Poshtme, në Veprën e Marrjes; Grejferin e pastrimit në Veprën e marrjes së ujit(HEC Koman); mekanizmat ngritës të Portave të Remonteve si dhe impiantet e Portave në Tunelet e Shkarkimit.
- Kryejnë me cilësi punimet e remontit që janë parashikuar sipas grafikut të miratuar dhe punimet e tjera të parashikura.
- Marrin pjesë dhe eliminonë difektet dhe avarite në pajisjet, sipas natyrës dhe funksionit.
- Kryejnë shërbime dhe përdorin pajisjet e trajtimit të vajit hidraulik.
- Marrin pjesë në hartimin e akteve teknike të difekteve dhe avarive të ndodhura në pajisjet që kanë objekt të punës së tyre, duke përshkruar me saktësi mënyrën e eliminimit, materialet e përdorura etj.

- Marrin pjesë në përpilimin e proçesverbaleve të remonteve të pajisjeve për të cilat përgjigjen.
- Marrin pjesë në komisione të ndryshme sipas urdhërave të Drejtorisë.
- Shfrytëzojnë, mirëmbajnë dhe remontojnë makineritë metal-prerëse, në bazë të kushteve dhe normave teknike.
- Mirëmbajnë dhe shfrytëzojnë pajisjet e saldimit me hark dhe oksigjen.
- Mirëmbajnë dhe përdorin pajisjet dhe instrumentat matëse dhe kontrolluese.
- Kryejnë kontrolle periodike në të gjitha pajisjet mekanike, hidraulike, impjantet e qarkullimit dhe injektimit të vajit, sistemet e ajrit, sistemet e ujit teknik, pajisjeve të Tuneleve të Shkarkimit, portat, vinçat etj.
- Kryejnë kontrolle, pastrime dhe sistemime në çdo vend pune, pajisje apo impiant që është objekt i punës së tyre.
- Zbatojnë Rregulloret e Shfrytezimit, Sigurimit Teknik dhe të MNZ, në të gjitha proçeset e punës ku ata marrin pjesë.
- Zbaton me përpikmëri kërkesat teknike të inxhinierëve të remontit mekanik të përfshirë në grupet e punës dhe në Fletën e Punimeve.
- Marrin pjesë një herë në vit në provimit për vendin e punës të organizuar nga drejtoria.

Paraqitja e dokumentave

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës **31.10.2025**, në adresën elektronike hr@kesh.al Departamentin e Burimeve Njerëzore këto dokumenta:

- ✓ Kërkesën për aplikim
- ✓ Curriculum Vitae
- ✓ Çertifikatë përbërje familjare
- ✓ Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara
- ✓ Çertifikata kualifikimi (në rast se ka)
- ✓ Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit
- ✓ Dëshmi e gjendjes gjyqësore dhe mjekësore

Mirald Hekuri
Departamenti i Burimeve Njerëzore
Drejtor